



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Tessa Tech Prishtina shpk" të datës 20.08.2026 kundër ftesës për ofertim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi (blerja) e pajisjeve të teknologjisë informative (kompjuterë, monitor dhe laptop Marrëveshjes publike kornize te AQP-se me nr. të ref. AQP;UA/2026-24-3927-1-1-1" me nr. të prokurimit 616-26-6616-5-5-8, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË si e pasafatshme kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Tessa Tech Prishtina shpk" të datës 20.08.2026 kundër ftesës për ofertim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi (blerja) e pajisjeve të teknologjisë informative (kompjuterë, monitor dhe laptop Marrëveshjes publike kornize te AQP-se me nr. të ref. AQP;UA/2026-24-3927-1-1-1" me nr. të prokurimit 616-26-6616-5-5-8.**
- II. VËRTETOHET njoftimi njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi si dhe **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj tutje me këtë procedurë të prokurimit.**
- III. NJOFTOHEN** të gjitha palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

Arsyetim

Operatori ekonomik "Tessa Tech Prishtina shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 20.08.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër ftesës për ofertim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi (blerja) e pajisjeve të teknologjisë informative (kompjuterë, monitor dhe laptop Marrëveshjes publike kornize te AQP-se me nr. të ref. AQP;UA/2026-24-3927-1-1-1" me nr. të prokurimit 616-26-6616-5-5-8. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur që sipas ftesës për ofertim hapja e ofertave është paracaktuar për datën 21.08.2026 nga ora 14:00.

Përmes nenit 60 par. 60.1 nënpar. a) të RRPP është përcaktuar se “Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0)”. Në rastin konkret dita zero (0) është data 21.08.2026 kur edhe panifikohej hapja e ofertave. Ndërsa dita e fundit kur ka mundur të parashtrohen kërkesat për rishqyrtim është data 15.08.2026. Mirëpo parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij për rishqyrtim me datë 20.08.2026 respektivisht kërkesa është dorëzuar pesë (5) ditë pas afatit ligjor. Në këtë mënyrë është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është jashtë afatit dhe duhet të hedhet poshtë si e tillë.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 paragrafin a) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si palejuar përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin a) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 21.08.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.